



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

PROJEKTVENDIM

Nr 16733, Datë 28. 08. 2026

Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr.113, datë 15.12.2025 “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit të Vitit 2026”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; Kryetari i Bashkisë i paraqet projektvendimin përkatës, Këshillit të Bashkisë;

Për të vendosur :

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në PBA-në 2026-2028 dhe në Buxhetin e Vitit 2026, konkretisht, si më poshtë:

1.1. Në pikën 1/a, të shtohen “Burimet e të ardhurave” për vitin 2026 në shumën 45,238,503 lekë, nga:

- Fondi i akorduar nga GIZ në shumën 42,178,500 lekë, bashkëfinancim për ndërtimin e Qëndres Multifunkionale.

- Të ardhurat e realizuar nga qiraja e sipërfaqeve pyjore në shumën 3,060,003 lekë.

1.2. Në pikën 1/b, të shtohet “Plani i shpenzimeve” për vitin 2026 në shumën 45,238,503 lekë për financimin e projekteve si më poshtë:

1.2.1. Ndërtimi i Qëndres Multifunkionale në shumën 42,178,500 lekë, respektivisht:

Nr	Programi	Funksioni	Produkti	Kap.	Art.	Shuma lekë	Emërtimi
1	AD127	05100	P510AAJ	02	231	31,617,073	Ndërtim Kapanoni në Qëndren Multifunksionale – Punime ndërtimi
						10,561,427	Rehabilitim i ndërtesave ekzistuese në Qëndren Multifunkionale – Punime

1.2.2. Pyllëzime të reja me fidan pyjor në shumën 3,060,003 lekë, respektivisht:

Nr	Programi	Funksioni	Produkti	Kap.	Art.	Shuma lekë	Emërtimi
1	AC127	04260	P426AAH	05	231	3,060,003	Pyllëzime-Mbjellje fidanë - Punime zbatimi

1.3. Të bëhet këto ndryshime në Buxhetin e Vitit 2026 dhe PBA-në 2026-2028, si më poshtë:

1.3.1. Të pakësohen shpenzimet në programet, në funksionet, produktet/projektet dhe artikujt, me emërtime në shumën 70,107,501 lekë:

-Për vitin 2026;

Nr	Programi	Funksioni	Produkti	Kap.	Art.	Shuma lekë	Emërtimi
1	AA127	01110	V111AAA	05	606	1,541,175	Fond i veçantë
			V111AAB	05	602	92,000	Botime periodike
						100,000	Fushatë komunikimi me qytetarët
						30,000	Trajnim këshilltarësh
						50,000	Shpenzime për dëgjesa publike
						53,400	Blerje durali dhe grila
			V111AAD	05	602	9,600	Printime dhe fotokopjime
						120,000	Blerje kafe
						120,000	Blerje ujë
						7,827	Karburant dhe lubrifikant
			V112AAB	05	606	510,000	Fond i veçantë
			V614AAB	05	602	6,657	Karburant dhe lubrifikant
					606	215,333	Fond i veçantë
			V614AAC	05	606	302,000	Fond i veçantë
2	AB127	03280	V328AAB	05	606	150,000	Fond i veçantë
			V328AAC	05	602	20,724	Karburant dhe lubrifikant
		10910	P091AAJ	05	231	94,683	Sistemim Përroi i Luzhisë-Mbikëqyrje punimesh
			P091AAK	05	231	1,424,894	Nd.Muri mbrojtës rr.Kune-Punime ndërtimi
			P091AAL	05	231	417,061	Rehabil.Prita Përroi Fishtë- Punime ndërtimi
						43,773	Rehabil.Prita Përroi Fishtë-Mbikëqyrje punimesh
3	17	10910	21AD502	01	231	1,543,919	Sistemim i pjeshëm Përroi i Luzhisë-Punime
4	AC127	04160	V416AAD	05	606	44,279	Fond i veçantë
		04220	V422AAD	05	606	320,000	Fond i veçantë
		04240	V424AAB	05	602	451,046	Blerje materiale për riparim kanale ujitëse
						122,310	Blerje materiale për riparim kanale kulluese
						461,096	Karburant dhe lubrifikant
				01	602	6,520	Karburant dhe lubrifikant
					231	800,000	Blerje rimorkiatori me kokë tërheqëse
			P424ABD	05	231	96,236	Kalimi i lumit Gjadër me tub çeliku në fshatin Gjadër – Punime ndërtimi
						388	Mbikëqyrje punimesh
			P424ABE	05	231	16,254	Kalimi i lumit Gjadër me tub çeliku në fshatin Dajç – Punime ndërtimi
						72	Mbikëqyrje punimesh
			P424ABF	05	231	274,817	Nd.Stacionit Pompave fsh.Dragushë-Punime
						210,130	Mbikëqyrje punimesh
		04260	V426AAA	05	602	1,000,000	Shpenzime për regjistrim pronash
					606	638,000	Fond i veçantë
5	AD127	04520	V452AAB	05	602	27,032	Benzinë
						45,705	Karburant dhe lubrifikant
		05100	V510AAB	05	602	6,360	Benzinë
						137,942	Karburant dhe lubrifikant
						164,152	Blerje kosha mbeturinash
			P510AAJ	05	231	49,975,978	Ndërtimi i Qëndres së Mbetjeve
		05630	V563AAB	05	606	45,333	Fond i veçantë
		06260	V626AAA	05	606	1,736,000	Fond i veçantë
			V626AAB	05	602	81,111	Sistemim dhe mirëmbajtje varrezash
			V626AAC	05	602	78,001	Benzinë
						96,239	Karburant dhe lubrifikant
						48,000	Ekspertizë dhe shërbime të jashtme për H.T

Nr	Programi	Funksioni	Produkti	Kap.	Art.	Shuma lekë	Emërtimi
			V626AAC	05	602	44,000	Ekspertizë dhe shërbime të jashtme për M.L
						183,125	Ekspertizë dhe shërbime të jashtme për Z.Dh
			V626AAC	05	602	416,875	Kosto zyre dhe administrative
						425,873	Ekspertizë-shërbime jashtme projekti Smart Land
			V626AAD	05	602	4,828	Mirëmbajtje gjelbërimi
			V626AAH	05	602	237,648	Materiale hidraulike
						369,560	Bojë për lyerje objektësh
			V637AAA	05	602	8,020	Karburant dhe lubrifikant
			V644AAB	05	602	4,812	Karburant dhe lubrifikant
						50,000	Pagesa e tarifave të policisë për aksidentet ZU
6	AE127	08220				3,000,000	Blerje pajisje/materiale projekti ProLighMed
			V644AAC	05	602	1,604	Karburant dhe lubrifikant
			V822AAA	05	606	285,333	Fond i veçantë
			V822AAC	05	602	2,213	Karburant dhe lubrifikant
			V822AAK	05	231	740	Ekspozitë xhami për libra
						13,040	F/V Grila Bibliotekës
7	AF127	08230	V823AAA	05	606	238,872	Fond i veçantë
		08130	V813AAA	05	606	41,333	Fond i veçantë
			V912AAA	05	606	170,000	Fond i veçantë
			V912AAB	05	602	38,135	Gazoil për kaldajat
						48,280	Gaz për ngrohje
		09120	V912AAD	05	602	129,431	Ushqime
			V923AAB	05	602	4,010	Gazoil për kaldajat
			V923AAF	05	602	26,211	Ushqime
8	AG127	10140	V014AAA	05	606	364,000	Fond i veçantë
			V014AAE	05	606	69,333	Fond i veçantë
				05	602	2,005	Karburant dhe lubrifikant
		10430	V043AAC	05	602	47,367	Ushqime
						15,200	Mirëmbajtje elektroshtëpiake
						53,314	Materiale ndërtimi
						24,690	Materiale elektrike
						10,484	Materiale hidraulike
						11,944	Bojë për lyerje
				231		2,400	Blerje pajisje për çerdhen
			V043AAD	05	602	774	Gaz për gatim
						26,000	Snack-Ushqime për fëmijë Q.K.Multifunkionale

-Për vitin 2027;

Nr	Programi	Funksioni	Produkti	Kap.	Art.	Shuma lekë	Emërtimi
1	AD127	06260	P626LE-06	05	231	17,359,128	Rehabilitimi i lulishteve në Lezhë e Shëngjin

1.3.2. Të shtohen shpenzimet në programet, në funksionet, produktet/projektet dhe artikujt, me këto emërtime në shumën 70,107,501 lekë:

-Për vitin 2026;

Nr	Programi	Funksioni	Produkti	Kap.	Art.	Shuma lekë	Emërtimi
1	AA127	01110	V111AAD	05	602	2,000,000	Shërbime postare
						100,000	Ujë i pijshëm
						1,080,144	Energji elektrike
2	AB127	03280	V328AAC	05	231	1,500,000	Blerje Autoboti për MZSH
		10910	V091AAC	05	606	5,336,500	Qira banese për familjet e dëmtuara nga termeti
3	17	10910	21AD502	01	231	1,543,919	Blerje Autoboti për MZSH

Nr	Programi	Funksioni	Produkti	Kap.	Art.	Shuma lekë	Emërtimi
4	AD127	05100	P510AAJ	05	231	40,340,706	Furnizim me pajisje për Qëndren Multifunksionale
						9,635,272	Furnizim e vendosje linjë transmetimi+presë
		05100	V510AAB	05	602	1,500,000	Blerje qese për pastrim mbeturinash
					231	350,000	Bl. pajisje e materiale për lavazhin e atomjeteve
			V510AAC	05	231	2,571,545	Blerje kamionçinë
5	AF127	09230	V923AAB	05	602	600,000	Ujë i pijshëm
			V923AAF	05	602	20,000	Ujë i pijshëm
6	AG127	10140	P014AAD	01	231	6,520	Qendra e Moshës Tretë-Mbikëqyrje punimesh
				05	231	3,522,895	Qendra e Moshës Tretë-Mbikëqyrje punimesh

-Për vitin 2027;

Nr	Programi	Funksioni	Produkti	Kap.	Art.	Shuma lekë	Emërtimi
1	AD127	05100	P510AAJ	05	231	8,431,900	Rehabilitim i ndërtesave ekzistuese për Qëndren Multifunksionale– Punime ndërtimi
						8,927,228	Furnizim dhe vendosje linjë transmetimi + presë për Qëndren Multifunksionale

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngakohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Emergjencave Civile, Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve, Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Kulturës dhe Trashegimisë Kulturore, Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social & Drejtoria Juridike.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

KRYETARI

Pjerin Ndreu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 16733/1 Prot

Lezhë, më 28 08.2026

RELACION

**LIDHUR ME PROJEKTVENDIMIN E PARAQITUR PËR PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE
SHITESË DHE DISA NDYSHIMEVE NË BUXHETIN E VITIT 2026**

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, relatoi si më poshtë:

- Referuar të dhënave të buxhetit për periudhën janar-gusht të vitit 2026 janë krijuar të ardhura shtesë me burim nga GIZ si donator për financimin e ndërtimit të Qëndres Multifunkionale në shumën 42,178,500 lekë dhe nga qiraja e tokës pyjore në shumën 3,060,003 lekë.

Këto të ardhura, si të ardhura me destinacion, ju propozoj që të përdoren për financimin e punimeve të ndërtimit të projektit me emërtim: “Qendra Multifunkionale Lezhë”, e konkretisht për:

- 1.Ndërtim Kapanoni në shumën 31,617,073 lekë;
- 2.Rehabilitim të Ndërtesave Ekzistuese në shumën 10,561,427 lekë dhe për projektin me emërtim: Pyllëzime të reja - Mbjedhje fidanë pyjor në shumën 3,060,003 lekë.

- Janë propozuar disa ndryshime në buxhetin e vitit 2026 në shumën 70,107,501 lekë dhe PBA-në 2026-2028 në shumën 17,359,128 lekë, respektivisht për:

- 1.Përdorimin e fondeve lira të krijuara mes fondit limit dhe vlerave të kontratave, si dhe disa fondeve të tjera në shumën gjithsej 18,587,604 lekë, të cilat do të mundësojnë financimin e disa aktiviteteve dhe projekteve që kërkojnë fonde shtesë.

- 2.Fondin e miratuar në Buxhetin e vitit 2026, për projektin: Ndërtim i Qëndres Ndarëse të Mbetjeve, për punime ndërtimi në shumën 49,975,978 lekë, kërkohet të bëhet një ndryshim në buxhet për tu përdorur për blerje pajisjesh, furnizim e vendosje linjë transmetimi dhe presë, për të mundësuar ndërtimin dhe funksionimin e Qëndres Multifunkionale, kjo kërkesë e donatorit GIZ, pas paraqitjes së projekt-preventivit përfundimtar.

- 3.Fondin e akorduar për investime nga AKMC-ja, si Transfertë e Kushtëzuar për vitin 2026, tepëricë e krijuar mes fondit limit dhe vlerave të kontratave në shumën 1,543,919 lekë, do të përdoret për blerje autoboti për MZSH-në.

- 4.Ndryshim kërkohet edhe në PBA-në 2026-2028, për vitin 2027, e konkretisht: Pakësim i fondit për projektin: Rehabilitimi i lulishteve të qytetit Lezhë dhe Shëngjin në shumën 17,359,128 lekë, për të mundësuar vazhdimin e financimit të projektit me emërtim: Qendra Multifunkionale, e

konkretisht për aktivitetet: a- Furnizim e vendosje linjë transmetimi dhe presë në shumën 8,927,228 lekë dhe b- Rehabilitim të Ndërtesave Ekzistuese në shumën 8,431,900 lekë.

Kërkesat dhe relacionet shpjegues më të detajuar janë paraqitur nga Drejtoritë përkatëse, lidhur me përdorimin e të ardhurave shtesë dhe ndryshimeve buxhetore të kërkuara.

Prandaj, kërkoj nga ana Juaj miratimin e këtij projektvendimi për të mundësuar ecurinë e zbatimit të 3 projekteve, për blerje mallrash e kryerje shërbimesh dhe për mbrojtjen sociale (qira banesash) të familjeve, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga termeti.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI

Pjerin Ndreu



BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJËRËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMËVE MBËSHTETËSE

Nr. 16658 Prot.

Lezhë më, 27.08.2026

MIRATOI
KRYETARI
PJERIN NDREU



Lënda: Kërkesë për ndryshim buxheti.

DREJTORISË SË FINANCËS DHE BUXHETIT

KËTU

Mbështetur në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në zbatim të ligjit nr.68 datë 27.04.2017 "Për Financat e vetëqeverisjes Vendore", të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.113, datë 15.12.2025 "Për miratimin e PBA 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor për vitin 2026", kërkojmë ndryshim buxheti në programet si më poshtë:

Të pakësohen shpenzimet në:

Të pakësohen shpenzimet në:

Nr.	Programi	Funksioni	Produkti	Kapitulli	Artikulli	Shuma /lekë	Emertimi
1.	AA127	01110	V111AAD	01	602	120,000	Blerje kafe
	Shërbimet Administrative dhe Menaxheriale	01110	V111AAD	01	602	120,000	Blerje ujë
		01120	V112AAB	05	606	510,000	Fond i vecantë
		06140	V614AAC	05	606	302,000	Fond i vecantë
		06140	V614AAB	05	606	215,333	Fond i vecantë
2.	AC127	04220	V422AAD	05	606	274,811	Fond i vecantë
	Çështjet e Përgjithshme Ekonomike	04260	V426AAA	05	606	638,000	Fond i vecantë
		04260	V426AAA	05	606	1,000,000	Shpenzime për regjistrimin e pronave
						3,180,144	

Të shtohen
në:

Nr.	Programi	Funksioni	Produkti	Kapitulli	Artikulli	Shuma /lekë	Emertimi
1.	AA127	01110	V111AAD	05	602	2,000,000	Shërbime postare
	Shërbimet Administrative dhe Menaxheriale	01110	V111AAD	05	602	100,000	Uji i pijshëm
		01110	V111AAD	05	606	1,080,144	Energji elektrike
						3,180,144	

Duke ju falendëruar për bashkëpunimin,

DREJTORI I BURIMEVE NJERËZORE
DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Jetmira Leka



DREJTORI BUJQËSISË, UJITJES
DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE

Paulin Gjergji





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 16638/1 Prot

Lezhë, më 27.8.2026

RELACION

Në kuadër të zbatimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2026, gjatë analizës së ecures së shpenzimeve dhe të nevojave të krijuara për vijimin normal të aktivitetit të institucionit, është evidentuar nevoja për rishpërndarjen e fondeve ndërmjet zërave buxhetorë.

Ndryshimi i propozuar vjen si rezultat i nevojës për të orientuar fondet e disponueshme drejt shpenzimeve që paraqesin nevojë më të madhe dhe që lidhen drejtpërdrejt me funksionimin e përditshëm të institucionit dhe ofrimin e shërbimeve administrative.

Nga analiza e fondeve të parashikuara në disa zëra të programeve AA127 – “Shërbimet Administrative dhe Menaxheriale” dhe AC127 – “Çështjet e Përgjithshme Ekonomike”, rezulton se një pjesë e fondeve të planifikuara mund të riallokohen, pa cenuar realizimin e aktiviteteve për të cilat ato janë parashikuar fillimisht.

Në këtë kuadër, kërkohet **pakësimi i fondeve në zërat buxhetorë të paraqitur në pasqyrën bashkëlidhur, në shumën totale 3,180,144 lekë**, dhe riallokimi i tyre në zëra ku është evidentuar nevojë e shtuar për fonde.

Konkretisht, fondet do të riallokohen për:

- **Shërbime postare – 2,000,000 lekë.**
Shtimi i këtij fondi është i nevojshëm për garantimin e vijimësisë së shërbimit postar dhe për përballimin e shpenzimeve që lidhen me dërgimin dhe marrjen e korrespondencës zyrtare të institucionit. Rritja e nevojës për këtë shërbim dhe detyrimet që duhet të përballohen deri në fund të vitit kërkojnë sigurimin e fondit të nevojshëm.
- **Ujë i pijshëm – 100,000 lekë.**
Ky fond kërkohet për përballimin e shpenzimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe garantimin e kushteve të nevojshme për funksionimin normal të ambienteve të institucionit.
- **Energji elektrike – 1,080,144 lekë.**
Shtimi i fondit për energjinë elektrike është i nevojshëm për përballimin e detyrimeve të krijuara dhe atyre që priten deri në fund të vitit, duke garantuar vijimësinë e furnizimit me energji elektrike dhe funksionimin normal të strukturave të Bashkisë.

Në anën tjetër, pakësimi i fondeve bëhet në zërat ku, bazuar në ecurinë e shpenzimeve dhe nevojat e evidentuara, rezulton se fondet e planifikuara nuk do të përdoren në masën e parashikuar fillimisht. Kjo mundëson përdorimin më racional dhe më efektiv të fondeve publike, duke i orientuar ato drejt nevojave aktuale dhe prioritare.

Ndryshimi i propozuar **nuk sjell rritje të buxhetit total**, por përfaqëson një rishpërndarje të fondeve brenda buxhetit të miratuar, në shumën **3,180,144 lekë**.

Sa më sipër, duke vlerësuar nevojën për garantimin e vijimësisë së shërbimeve dhe përmbushjen e detyrimeve financiare të institucionit, kërkojmë miratimin e ndryshimit buxhetor sipas pasqyrave bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI I BURIMEVE NJERËZORE
DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Jetmira Leka

DREJTORI BUJQËSISË, UJITJES
DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE

Paulin Gjergji



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILENr. 16463 ProtLezhë, më 29. 08. 2028MIRATOHET
KRYETARI
PJERIN NDBEU

Lënda: Kërkesë për alokim fondi në Programin Buxhetor AB127, Funkzioni 10910.

DREJTORISË SË FINANCËS DHE BUXHETIT

KËTU

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar; të ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; të ligjit Nr.9936, datë 26.06. 2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; të Udhëzimit Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", VKB nr. 113 datë 15.12.2025 "Për miratimin e programit Buxhetor Afatmesëm dhe Buxhetin e vitit 2026, ju kërkoj alokimin e fondit në shumën 5,336,500 lekë në programin Buxhetor AB127 funksioni 10910 për mbulimin e shpenzimeve për qiratë e banesave për familjet e dëmtuara nga tërmeti. Për këtë ju propozoj:

1. Të pakësohen fondet në Buxhetin e vitit 2026, në Programetn Buxhetore AA127 në shumën 1,594,575 lekë , AB127 në shumën 2,130,411 lekë, AC127 në shumën 669,423 lekë dhe AD127 në shumën 942,091 lekë sipas funksioneve, produkteve dhe strukturave ekonomike si mëposhtë:

Nr	Programi	Funksioni	Produkti	Kap	Artikull	Shuma lekë	Emërtimi
1	AB127 Rendi dhe Siguria Publike	10910	V328AAB	05	606	150,000	Fondi i Veçantë EMC
			P091AAJ	05	231	94,683	Mbikëqyrje punimesh-Sist.Përroi i Luzhisë
			P091AAL	05	231	43,773	Mbikëqyrje punimesh - Prita Përroi Fishtë
			P091AAK	05	231	1,424,894	Punime-Ndertimi muri mbrojtës Rr.Kunes
			P091AAL	05	231	417,061	Punime-Rehabilitim Prita Malore Përroi Fishtë
2	AA127 Shërbimet Administrative dhe Menaxheriale	01110	V111AAA	05	606	1,541,175	Fondi i Veçantë
			V111AAD	05	231	53,400	Blerje Dural & Grila
3	AC127 Çështjet e Përgjithshme Ekonomike	04240	V424AAB	05	602	451,046	Materiale për riparim kanale ujitëse
					602	122,310	Materjale për riparim kanale kulluese
					231	96,067	Blerje Rimorkiator me kokë tërheqëse



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

4	AD127 Infrastruktura, Mjedisi dhe Sh. Publike	05100	V510AAB	05	231	164,152	Blerje kosha mbeturinash
		06260	V626AAD	05	602	4,828	Mirëmbajtje gjelbërimi
			V626AAB	05	602	81,111	Sistemim dhe mirëmbajtje varrezash
			V626AAC	05	602	48,000	Ekspertize dhe shërbime të jashtme për Hartat Territoriale në Lezhë
						44,000	Ekspertize dhe shërbime të jashtme për Modelin Lezha
						183,125	Ekspertize dhe shërbime të jashtme për Zbatimin e të Dhenave
						416,875	Kosto zyre dhe administrative

2. Të shtohen fondet në Buxhetin e vitit 2026, në Programin Buxhetor AB127 në shumën 5,336,500 lekë në funksionin, produktin dhe strukturën ekonomike si mëposhtë:

Nr	Programi	Funksioni	Produkti	Kap	Artikull	Shuma lekë	Emërtimi
1	AB127 Rendi dhe Siguria Publike	10910	V091AAC	05	606	5,336,500	Qira banese për familjet e dëmtuara nga tërmeti

Bashkelidhur relacioni shpjegues.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTORI I EMERGJENCAVE
Gjergj PRENDI

DREJTORI I BURIMEVE NJEREZORE DHE
DHE SHERBIMEVE MBESHTETESE
Jetmira LEKA

DREJTORI I BUJQESISE, UJITJES DHE
ADMINISTRIMIT TE PYJEVE
Paulin GJERGJI

DREJTORI I SHERBIMEVE PUBLIKE
INFRASTRUKTURES, TRANSPORT DHE MJEDISIT
Jurgen MARKU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

RELACION

Mbi kërkesën për alokim fondi në Programin Buxhetor AB127, Funkcioni 10910.

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; të ligjit Nr.9936, datë 26.06. 2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; të Udhëzimit Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, VKB Nr.113 date 15.12.2025” Per miratimin e programit Buxhetor Afatmesem dhe Buxhetin e vitit 2026

Në kuader të trajtimit të familjeve të prekura nga termeti me bonus qiraje,

Bazuar në Vendimin nr.27 datë 26.03.2026 “Për miratimin e pagesës së plotë të qerasë sipas vlerës së tregut të përcaktuar”, me VKB nr.93 datë 30.10.2025 për 49 familje të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, fondi i planifikuar në buxhetin e bashkisë nuk është i mjaftueshëm për të përballuar nevojat e llogaritura për këtë program, prandaj kërkojmë që të behet ky ndryshim buxhetor për mbulimin e nevojës financiare për pagesën e bonusit të qirasë për familjet përfituese. Ju kërkoj alokimin e fondit në shumën 5,336,500 lekë në programin Buxhetor AB127 funksioni 10910 për mbulimin e këtyre shpenzimeve.

Ky ndryshim do të mundësojë vijimin e trajtimit të familjeve përfituese, në përputhje me detyrimet dhe përcaktimet ligjore në fuqi.

DREJTORI I EMERGJENCAVE
Gjergj PRENDI

DREJTORI I BURIMEV NJEREZORE DHE
DHE SHERBIMEVE MBESHTETESE

Jetmira LEKA

DREJTORI I BUJQESISE, UJITJES DHE
ADMINISTRIMIT TE PYJEVE
Paulin GJERGJI

DREJTORI I SHERBIMEVE PUBLIKE
INFRASTRUKTURES, TRANSPORTIT DHE MJEDISIT
Jurgen MARKU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 16712 Prot

Lezhë, më 27.08/2026

MIRATOI
KRYETARI
Pjerin NDREU



Lënda: : Kërkesë për disa ndryshime në buxhetin e vitit 2026.

DREJTORISË SË FINANCËS DHE BUXHETIT

KËTU

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015''Për Vetëqeverisjen Vendore'', Ligji Nr.68 date 24.07.2017 ''Per Financat e Vetëqeverisjes Vendore'', Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.9 datë 20.03.2018 ''Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, VKB Nr.113 date 15.12.2025 '' Për miratimin e Programit Buxhetor 2026-2028 dhe Buxhetin e vitit 2026'', i ndryshuar, ju kërkoj që në buxhetin e vitit 2026 të bëhen këto ndryshime si mëposhtë:

1. Të pakësohen shpenzimet buxhetore në shumën 3,043,919 lekë në programet AD127 ''Infrastruktura dhe Mjedisi'' në shumën 1,500,000 lekë dhe Programi 17 në shumën 1,543,919 lekë, sipas programeve, funksioneve, produkteve, artikujve dhe emërtimeve si më poshtë:

Nr	Progr.	Funksion	Produkti	Kapitulli	Artikulli	Emertimi	Shuma
1	AD127	06440	V644AAB	05	602	Projekti Prolight Med Blerje paisje materiale	1,500,000
2	17	10910	21AD502	01	231	Sistemim i pjesshem i Perroit te Luzhise,Kallmet	1,543,919

2. Të shtohen shpenzimet në shumën 3,043,919 lekë në programin, funksionin, produktin, artikullin dhe me emërtimin si më poshtë:


Nr	Progr.	Funksion	Produkti	Kapitulli	Artikulli	Emertimi	Shuma
1	AB127	03280	V328AAC	05	231	Blerje Autoboti MZSH	1,500,000
2	17	10910	21AD502	01	231	Blerje Autoboti MZSH	1,543,919

Bashkëlidhur relacioni shpjegues.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI I EMERGJENCAVE
Gjergj PRENDI



DREJTORI I SHERBIMEVE PUBLIKE
INFRASTRUKTURES, TRANSPORTIT
DHE MJEDISIT
Jurgen MARKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E EMERGJENCEVE CIVILE

Nr. 16712/, prot

Dt. 27-08-2016

RELACION

Mbi Kërkesën për disa ndryshime në buxhetin e vitit 2026.

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015''Për Vetëqeverisjen Vendore'', Ligji Nr.68 date 24.07.2017 ''Per Financat e Vetëqeverisjes Vendore''Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.9 datë 20.03.2018 ''Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, VKB Nr.113 date 15.12.2025''Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesem dhe Buxhetin e vitit 2026,

Duke marrë në konsideratë nevojat e Bashkisë Lezhë për forcimin e kapaciteteve operacionale në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe përmirësimin e mjeteve në dispozicion të strukturave të emergjencave dhe shërbimit zjarrefikës, vlerësohet e nevojshme blerja e një autoboti zjarrefikës. Blerja e këtij automjeti do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve të reagimit ndaj situatave të zjarreve, veçanërisht në zonat rurale dhe ato me akses të vështirë, si dhe në përmirësimin e efektivitetit të ndërhyrjeve në raste emergjencash.

Gjithashtu, pajisja e strukturave përkatëse me mjete të përshtatshme operacionale do të mundësojë një menaxhim më të mirë të situatave emergjente, duke kontribuar në mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve, pronës, infrastrukturës dhe mjedisit.

Vlera e autobotit zjarrefikes është 3,043,919 lekë.

Duke qene se në programin 10910, Produktin 21AD502, kapitulli 01, Artikulli 231 me emertim ''Sistemim i pjesshem i Përroit të Luzhisë, Njësia Administrative Kallmet'' kemi një tepricë me vlerë prej 1,543,919 lekë dhe ne Programin 06440,Produktin V644AAB, kap 05, artikulli 602 me emertim'' Projekti proligh Med Materiale Ndertimi'' me vlere prej 1,500,000 leke.

Prandaj propozojmë kete ndryshim buxhetor per blerjen e autobotit zjarrefikes.

DREJTORI I EMERGJENCEVE
Gjergj PRENDI

DREJTORI I SHERBIMEVE PUBLIKE
INFRASTRUKTURES, TRANSPORTIT
DHE MJEDISIT
Jurgen MARKU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 16494 Prot.

Lezhë, më 25 / 08 / 2026

MIRATOHET

KRYETARI

Pjetër NDREU

Lënda: Kërkesë për shtesë dhe ndryshim në buxhetin e vitit 2026.

DREJTORISË SË FINANCËS DHE BUXHETIT

KËTU

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, kërkoj të bëhet shtesë në buxhetin e vitit 2026 në programin AC127, në Funkcionin 04260 “Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave”, në projektin “Pyllëzim me fidanë pyjor në ngastrën pyjore numër 1b, në ekonominë pyjore Zadrinë, Njësia Administrative Blinisht” që do të përdoret si më poshtë:

1. Të shtohen të ardhurat në shumën 3,060,003 lekë, për vitin 2026.
2. Të shtohen shpenzimet në buxhetin e vitit 2026, në shumën 3,060,003 lekë, në programin AC127 me funksion “04260”, si më poshtë:

Nr	Programi	Funksioni	Produkti	Kap	Art	Shuma lekë	Emërtimi
1	AC127 “Çështjet e Përgjithshme Ekonomike”	04260	P426AAH	05	231	3,060,003	Punimeve, zbatime pyllëzimi

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

DREJTORI
Paulin GJERGJI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 16494 Prot.

Lezhë, më 25/08 .2026

RELACION

“PËR KRYERJEN E PYLLËZIMIT TË PLANIFIKUAR NË EKONOMINË PYJORE ZADRIMË”

Në zbatim të planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore “Zadrimë” janë evidentuar disa objekte për ndërhyrjen me punime, në shtimin e sipërfaqes pyjore me fidanë pyjor. Këto ndërhyrje janë të planifikuara për parcelat pyjore me bimësi të ulët pyjore (ku mungon pylli) dhe në zonat çveshura apo të shpyllëzuara si dhe në prroskat që vërshojnë vrullshëm nga mali drejt zonave të banuara duke transportuar inerte dhe dhera. Nëpërmjet pyllëzimeve që do kryhen do të instalohet pylli i së ardhmes me fokus rritjen e ekonomisë lokale që buron nga prodhimi i lëndës së punimit, druve të zjarrit apo nënprodukteve të tjera pyjore. Ky investim do të zbatohet në mbështetje të pikës 3 të VKM-së numër 71 datë 29.01.2025 “Për heqjen nga fondi pyjor privat, ndryshimin e kategorisë së përdorimit dhe pakësimin në volum të sipërfaqes prej 3 ha në Ekonominë Pyjore Mali i Rrencit, të Bashkisë Lezhë, për ndërtimin e objekteve me funksion banimi dhe shërbimi me 1-6 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë dhe të objektit me funksion hoteleri dhe kazino me 2, 4, 6 dhe 7 kate mbi tokë dhe me 2 kate nën tokë, nga shoqëria “Dukagjini Group” sh.p.k”.

Fondi për realizimin e këtij investimi është **9.732.814,16** lekë.

